

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	05.03.2025	Kërkesa për informacion mbi kostot, aktivitetet dhe pjesëmarrësit e Samiteve të Diasporës. Qytetari kërkoi informacion mbi koston financiare të tre samiteve të Diasporës, aktivitetet e organizuara për secilin, listën e pjesëmarrësve (përfshirë funksionet e tyre publike), ministrinë përgjegjëse dhe bazën ligjore për organizimin dhe financimin e tyre. Kërkesa për informacion mbi Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Qytetari kërkoi informacion mbi misionin, statusin, organikën, bazën ligjore, buxhetin për vitin 2024 dhe parashikimin për	06.03.2025	- U informua se kërkesa nuk përmbante të gjithë elementët ligjorë sipas nenit 11 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe se duhet të ridërgohet në formatin e saktë, duke përfshirë emrin, mbiemrin, adresën dhe nënshkrimin. - Më pas, kërkuesi u informua se informacioni mbi Samitin e II-të të Diasporës është publik dhe mund të aksesohet online, ndërsa për trajtimin e mëtejshëm të kërkesës u kërkua specifikimi i arsyes dhe qëllimit të përdorimit të informacionit. Për sa i përket organizimit të samiteve, u sqarua se Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk është institucioni përgjegjës dhe nuk e disponon informacionin e kërkuar, ndaj kërkesa iu përcoll për trajtim Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si institucioni përgjegjës për fushën e diasporës. - U informua se Agjencia është një institucion në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, i krijuar me VKM nr. 120, datë 6.3.2024. Misioni i saj është të promovojë vlerat e diasporës dhe të ndjekë zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Struktura përbëhet nga 16 punonjës të miratuar, ndërsa aktualisht ka 11. Për më shumë informacion, iu	Nëpërmjet postës elektronike	Pa tarifë

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

		vitin 2025 të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.		rekomandua të vizitojë faqen zyrtare të Agjencisë.		
--	--	---	--	--	--	--

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.